



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2022:198719

Datë: 20.02.2023

Numri i dokumentit: 03990674

P.nr.173/2022

- GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Fatos Sejdijaj me zyrtaren ligjore Mirlinda Gashi, si procembajtëse, në çështjen penale ndaj të akuzuarit B. K. me adresë vendbanimi në Fshatin ... Komuna Skenderaj Rr.”...” për shkak të veprës penale-Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074 (tutje:KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë–Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1764/2022 të datës 12.09.2022, duke vendosur lidhur me Marrëveshjen e Ndërmjetësimit ND.nr.08/2023 të datës 06.02.2023, të lidhur në mes të akuzuarit B. K. dhe të dëmtuarës Kompania Rajonale Ujësjiellësi “Mitrovica” Sh.A., të cilën e përfaqësoi me autorizim me shkrim M. S.-Udhëheqës për Çështje Ligjore, jashtë seancës e në mbështetje të nenit 357 par.1, nënpar.1.3 të Kodit Nr.08/L-032 të Procedurës Penale (tutje:KPP), nenit 2 par. 2, nenit 8 dhe nenit 15 par. 1 të Ligjit nr.06/L-009 për Ndërmjetësim (tutje: Ligji për Ndërmjetësim), nenit 3 par.3 dhe nenit 17 par.1 të Rregullorës Nr.04/2019 për Procedurën e Ndërmjetësimit të Lëndëve të Gjykatave, (tutje: Rregullorja për Procedurën e Ndërmjetësimit të Lëndëve të Gjykatave), me datë 20.02.2023, nxjerr këtë :

A K T V E N D I M

I.- APROVOHET Marrëveshja e Ndërmjetësimit ND.nr.08/2023 e datës 06.02.2023, e lidhur në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega Skenderaj, në mes palëve-të akuzuarit B. K. dhe të dëmtuarës Kompania Rajonale Ujësjiellësi “Mitrovica” Sh.A., të cilën e përfaqësoi me autorizim me shkrim M. S..

II.- HEDHET Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë–Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1764/2022 e datës 12.09.2022, dhe **PUSHOHET** procedura penale kundër të akuzuarit **B. K.** nga i ati B. i lindur me datë ... në ..., ku edhe tani jeton, Rr.”...” - Komuna Skenderaj, me numër personal

..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, për veprën penale – Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

III.- Shpenzimet e procedurës penale mbulohen nga mjetet e gjykatës.

- A r s y e t i m -

- Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar Aktakuzën PP.II.nr.1764/2022 të datës 12.09.2022, kundër të akuzuarit B. K. me adresë vendbanimi në ... Rr. “...”-Komuna Skenderaj, për shkak të veprës penale-Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe në bazë të nenit 493 par.1 dhe 2 të KPP-së, ka kërkuar nga gjykata që të akuzurit t’i shqiptojë urdhrin ndëshkimor-dënim me gjobë pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, me arsyetimin se janë siguruar prova të besueshme se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

- Gjykata Themelore në Mitrovcië-Dega Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, me Aktgjykimin P.nr.173/2023 datë 20.12.2022, ndaj të akuzuarit ka dhënë urdër ndëshkimor duke i shqiptuar dënim me gjobë, kundër të cilit aktgjykim brenda afatit ligjor i akuzuari ka prashtruar kundërshtim, me datë 19.01.2023 dhe i ka propozuar gjykatës që nëse kjo çështje penale i plotëson kushtet ligjore të dërgohet në procedurë të ndërmjetësimit.

- Lidhur me propozimin e të akuzuarit, që kjo lëndë penale të procedohet në procedurën alternative të ndërmjetësimit, gjykata përmes e-mail adresës elektronike zyrtare me datë 19.01.2023, Udhëheqësin për çështje ligjore të të dëmtuarës Kompanisë Rajonale Ujësjiellësi Mitrovica-M. S. e ka njoftuar përmes e-mailit të tij personal si në shkresat e lëndës ashtu që, i njëjti me parashtrësën me shkrim dorëzuar përmes e-mailit zyrtar të datës 20.01.2023 ka deklaruar se janë të pajtimit dhe japin pëlqimin për referimin e kësaj lënde penale në ndërmjetësim dhe gjykata me vendim procedural të datës 23.01.2023 e ka referuar dhe dërguar këtë lëndë në procedurë të ndërmjetësimit, e cila lëndë nga referenti përkatës i ndërmjetësimit i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, është pranuar me datë 27.01.2023.

- Me datën 06.02.2023, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega Skenderaj është arritur Marrëveshja e Ndërmjetësimit ND.nr.08/2023, në mes palëve në procedurë dhe atë në mes palëve-të akuzuarit B. K. dhe të dëmtuarës Kompania Rajonale Ujësjiellësi “Mitrovica” Sh.A., të cilën e përfaqësoi me autorizim me shkrim M. S.-Udhëheqës për Çështje Ligjore, procedurë të cilin e udhëheqi Ndërmjetësuesi i licencuar Hatixhe Ahmeti, e të cilën marrëveshje gjykata e ka pranuar me datë 14.02.2023.

- Andaj, Gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 2 par.2, dhe nenit 15 par. 1 të Ligjit për Ndërmjetësim si dhe dispozitave të nenit 3 par.3 dhe nenit 17 par.1 të Rregullorës për Procedurën e Ndërmjetësimit të Lëndëve të Gjykatave, e aprovoi këtë marrëveshje pasi që të njëjtën e vlerësoi që është lidhur me vullnetin e palëve në procedurë dhe në pajtim me ligjin në fuqi.
- Gjykata, pasi ka vërtetuar se në këtë çështje penale është arritur marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit, sipas Ligjit për Ndërmjetësim, dhe aprovimit të kësaj marrëveshje nga ana e Gjykatës duke u mbështetur në nenin 15 par. 1 të Ligjit për Ndërmjetësim dhe nenit 17 par.1 të Rregullorës për Procedurën e Ndërmjetësimit të Lëndëve të Gjykatave, Gjykata konstaton se kjo është një rrethanë e cila e pengon ndjekjen e mëtejme penale dhe mbi bazën e këtyre arsyeve e duke u bazuar në nenin 357 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së, vendosi që të hedhë akuzën dhe të pushojë procedurën penale ndaj të akuzuarit.
- Konform nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim dhe nenit 17 par.1 të Rregullorës për Procedurën e Ndërmjetësimit të Lëndëve të Gjykatave, në datën e aprovimit të kësaj marrëveshje nga gjykata, e njëjta do ta ketë fuqinë e dokumentit përmbarues.
- Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e bazoi në nenin 453 par. 1 të KPP-së, pasi që është pushuar procedura penale, ndërsa që i akuzuari i ka paguar vetë shpenzimet e ndërmjetësimit në atë procedurë.
- Nga sa u tha më lartë dhe konform nenit 357 par.1 nënpar. 1.3 të KPP-së, e lidhur me nenin 2 dhe nenin 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ

- Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal

P.nr.173/2022 më datë 20.02.2023.

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Fatos Sejdijaj

- **KËSHILLË JURIDIKE** : Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa e personave të autorizuar në afatin prej tre (3) ditësh nga pranimi i tij, nëpërmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.